

LC WAIKIKI Retail AL Sh.p.k

Pasqyrat financiare
per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

(dhe raporti i audituesit te pavarur)



Permbajtja

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

	I,II
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjithepershires	2
Pasqyra e ndryshimeve ne kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
1 Informacion i pergjithshem	5
2 Ndryshimet ne politika kontabel	6
3 Politika kontabel te rendesishme	13
4 Menaxhimi i rrezikut financiar	21
5 Gjykime dhe vleresime te rendesishme kontabel	22
6 Aktivet afatgjata materiale	23
7 Aktivet afatgjata jo-materiale	23
8 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	24
9 Inventari	24
10 Kliente dhe te tjera te arketueshme	24
11 Parapagim/ (detyrim) per tatim fitimin	24
12 Furnitore dhe detyrime te tjera	25
13 Provizione per shpenzime	25
14 Te ardhura nga shitjet	25
15 Kosto e mallrave te shitur	26
16 Shpenzime per punonjesit	26
17 Shpenzime te pergjithshme dhe administrative	26
18 Shpenzime te tjera	27
19 Fitime/ (humbje) nga kembimet valutore	27
20 Tatim fitimi	27
21 Angazhime dhe detyrime te kushtezuara	27
22 Transaksione me palet e lidhura	32
23 Ngjarjet pas dates te raportimit	32
24 Shpjegime te tranzicionit ne SNRF	32





BAKER TILLY ALBANIA

Rr. Themistokli Gërmenji,
Nr.2
Pall. Ambasador 1, 3-rd
floor
Tirana
Albania

T: +355(0)42232726

office@bakertillyalbania.com
www.bakertillyalbania.com

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të LC WAIKIKI Retail AL Sh.p.k, që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2015, pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabile dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar miratuar me Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brëndshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrime apo pasaktësira; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përftojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshin procedurë për të marrë evidencë auditimi për vlerat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë dhe vlerësimin e riskut të egzistencës së gabimeve materiale në pasqyrat financiare, qofshin rezultat i mashtrimeve apo pasaktësira. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, audituesi konsideron kontrollin e brëndshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brëndshëm të shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

Opinion

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare të LC WAIKIKI Retail AL Sh.p.k paraqesin në mënyrë të sinqertë në të gjitha aspektet materiale gjëndjen financiare të shoqërisë më 31 Dhjetor 2015, rezultatin financiar dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar miratuar me Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Baker Tilly Albania shpk.

Elton Haxhi
Ekspert Kontabël i Regjistruar

Tiranë
28 Qershor 2016

LC WAIKIKI RETAIL Al Sh.p.k

Pasqyra e pozicionit financiar

me 31 Dhjetor 2015

(Vlerat ne Lek)

	Shenime	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
AKTIVI				
Aktive afatgjata materiale	6	322.430.604	270.837.612	191.972.402
Aktive afatgjata jomateriale	7	3.678.331	3.611.516	3.012.917
Totali i aktiveve afatgjate		326.108.935	274.449.128	194.985.319
Mjete monetare	8	322.652.380	274.794.287	113.883.022
Inventari	9	159.390.278	168.340.371	126.780.534
Kliente dhe te tjera kerkesa te arketueshme	10	10.583.469	7.725.602	4.479.651
Tatim fitimi	11	442.631	-	-
Totali i aktiveve afatshkurter		493.068.758	450.860.260	245.143.207
TOTALI I AKTIVEVE		819.177.693	725.309.388	440.128.526
KAPITALI DHE DETYRIMET				
Furnitore dhe detyrime te tjera	12	48.113.597	72.959.654	63.188.482
Detyrime per tatim fitimi	11	-	18.459.576	8.369.054
Provizione per shpenzime	13	17.454	1.541.927	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		48.131.051	92.961.157	71.557.536
Total i detyrimeve		48.131.051	92.961.157	71.557.536
Kapitali i nenshkruar		50.000.000	50.000.000	50.000.000
Rezerva ligjore		5.000.000	5.000.000	5.000.000
Fitime/(humbje) e mbartur		716.046.642	577.348.231	313.570.990
Kapitalet e veta		771.046.642	632.348.231	368.570.990
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		819.177.693	725.309.388	440.128.526

Pasqyra e pozicionit financiar duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 34 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

Keto pasqyra financiare jane aprovuar me 30 mars 2016 dhe jane firmosur ne emer te tij nga:

Harun Demirtas

Drejtor i Pergjithshem



Majlinda Hila

Shefe finance

LC WAIKIKI RETAIL Al Sh.p.k

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave te tjera gjithepershires

per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

(Vlerat ne Lek)

Shenime	Viti i mbyllur		
	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014	
Te ardhura nga shitjet	14	1.632.652.968	1.342.305.050
Kosto e mallrave te shitur	15	(932.386.441)	(716.225.140)
Marzhi bruto		700.266.527	626.079.910
Shpenzimet Operative			
Shpenzime per punonjesit	16	96.611.303	80.283.610
Shpenzime te pergjithshme dhe administrative	17	220.644.623	196.840.573
Shpenzime te tjera	18	18.416.626	10.481.394
Provizione per shpenzime	13	-	1.541.928
Amortizimi		22.180.538	18.606.217
Totali i shpenzimeve operative		357.853.090	307.753.722
Rimarrje provizionesh		-	-
Te ardhura/(shpenzime) te tjera		434.211	179.890
Fitimi nga aktiviteti kryesor		342.847.648	318.506.078
Fitime/(Humbje) nga interesat		-	(2.497.417)
Fitime/(Humbje) nga konvertimi	19	(5.527.021)	(4.150.394)
Fitime/(humbje) financiare		(5.527.021)	(6.647.811)
Fitimi para tatimit		337.320.627	311.858.267
Tatimi mbi fitimin	20	(52.151.344)	(48.081.027)
Fitimi neto per vitin		285.169.283	263.777.240
Te ardhura te tjera gjithepershires		-	-
Totali i te ardhurave gjithepershires per vitin		285.169.283	263.777.240

Pasqyra e te ardhurave duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 34 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.



LC WAIKIKI RETAIL AL Sh.p.k

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital

per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

(Vlerat ne Lek)

	Kapitali i nenshkruar	Rezerva Ligjore	Fitime te mbartura	Totali
Gjendje ne 01 Janar 2014	50.000.000	5.000.000	313.570.990	368.570.990
Rezerva ligjore nga fitimi 2014				-
Fitimi i vitit 2014			263.777.241	263.777.241
Gjendje ne 31 Dhjetor 2014	50.000.000	5.000.000	577.348.231	632.348.231
Rezerva ligjore nga fitimi 2015				-
Dividende te paguar			(146.470.870)	(146.470.870)
Fitimi i vitit 2015			285.169.281	285.169.282
Gjendje ne 31 Dhjetor 2015	50.000.000	5.000.000	716.046.642	771.046.642

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 34 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.



LC WAIKIKI RETAIL Al Sh.p.k

Pasqyra e flukseve monetare

per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

(Vlerat ne Lek)

Shenime	Viti I mbyllur	
	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
Fitime/(humbje) perpara tatimit	337.320.626	311.858.267
<i>Korrigjime per:</i>		
Amortizimi	6,7 22.180.538	18.606.217
Provizione perdorur gjate vitit	13 (1.541.928)	-
Rritje/(ulje) provizionet per kthimet e shitjeve	17.453	1.541.928
Shpenzime per interesa		
Fitimi nga aktiviteti perpara ndryshimeve ne kapitalin punues	357.976.689	332.006.412
(Rritje)/ulje ne inventar	8.950.093	(41.559.837)
(Rritje)/ulje ne kliente dhe te tjera kerkesa per arketim	(2.857.867)	(3.245.951)
Rritje/(ulje) ne furnitore dhe detyrimet e tjera	(24.846.057)	9.771.172
<i>Fluksi i parase nga aktiviteti kryesor</i>	<i>339.222.858</i>	<i>296.971.796</i>
Tatim fitimi i paguar	(71.053.553)	(37.990.505)
Fluksi neto i parase nga aktiviteti kryesor	268.169.305	258.981.291
Fluksi nga aktiviteti investues		
Blerje aktive afatgjata materiale	6,7 (74.113.723)	(98.070.026)
Dalje aktive afatgjata materiale	6,7 273.381	-
Fluksi neto nga investimet	(73.840.342)	(98.070.026)
Fluksi nga aktiviteti financues		
Dividende	(146.470.870)	-
Fluksi neto nga financimet	(146.470.870)	-
Rritja/(pakesimi) neto ne mjete monetare	47.858.093	160.911.265
Mjete monetare ne 1 Janar	8 274.794.287	113.883.022
Mjete monetare ne 31 Dhjetor	8 322.652.380	274.794.287

Pasqyra e flukseve monetare duhet lexuar se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 5 deri 34 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

LC WAIKIKI RETAIL Al Sh.p.k

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

(Vlerat ne Lek)

1 Informacion i përgjithshem

Shoqeria LC Waikiki Retail Al Shpk. (me poshte 'Shoqeria') eshte krijuar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne date 05/03/2010.

Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise perfshin tregtimin, import-eksport dhe shitje me pakice e shumice te mallrave, sipermarrje dhe sherbime ne fusha te ndryshme. Shitje me shumice e pakice e tekstileve, veshjeve, veshjeve sportive, kepuceve dhe artikujve te lekures neper panaire, stenda e dyqane te specializuara.

Kapitali i nenshkruar dhe struktura aksionare me 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 paraqiten si me poshte:

	31 Dhjetor 2015		31 Dhjetor 2014	
	Ne %	Ne Vlere	Ne %	Ne Vlere
LC Waikiki Magazacilik Hizmetleri Ticaret AS	100%	50.000.000	100%	50.000.000
	<u>100%</u>	<u>50.000.000</u>	<u>100%</u>	<u>50.000.000</u>

Me 31 Dhjetor 2015 shoqeria kishte 143 te punesuar (31 Dhjetor 2014 : 113 punonjes). Adresa e shoqerise eshte Njesia Bashkiake Nr. 10. Sheshi Skenderbe, Pallati i Kultures, Tirane. Shoqeria eshte regjistruar si tatimpagues ne rrethin e Tiranës me NIPT L01508008R.

Pasqyrat financiare te shoqerise per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015 jane miratuar nga Administratori i shoqerise me 30 Mars 2016.

2 Ndryshimet ne politika kontabël

2.1 Standardet e reja dhe ato të ndryshuara efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose pas datës 1 janar 2015

Disa standarde të reja dhe të rishikuara janë efektive për periudhat vjetore duke filluar më ose më pas 1 janarit 2015. Asnje nga keto ndryshime nuk ka efekt ne pozicionin financiar te Shoqerise.

- Rishikim i SNK 19 - Planet per përfitime të përcaktuara: Kontributet e punonjësve

-Rishikime te SNRF dhe përmirësime te ciklit te SNRF 2010-2012

- SNRF 2 – *Pagesat bazuar ne aksione* - Përcaktimi i gjendjes së kushtëzimit
- SNRF 3 – *Kombinimet e Bizneseve - Kontabiliteti për detyrimet e mundshme ne në një kombinim biznesi*
- SNRF 8 - Segmentet e shfrytëzimit (i) Shenime shpjeguese në lidhje me gjykimet e përfshirë në përcaktimin ose jo të bashkimit te segmentet e shfrytëzimit; (ii) Rakordimi i totalit e aktiveve te segmenteve raportuese në aktivet e njësisë ekonomike me totali e aktiveve te Shoqerise.
- SNRF 13 - *Vlera e drejtë e matjes* – Llogari te arkëtueshme dhe te pagueshment afatshkurtër
- SNK 16 - *Aktivitet Afatgjata Materiale dhe SNK 38 - Aktivitet jo-materiale* – Metoda e Rivlerësimi e barabartë me riparaqitjen proporcionale te amortizimin e akumuluar (amortizimit)

-Rishikime te SNRF dhe përmirësime te ciklit te SNRF 2010-2012

• SNRF 3 - *Kombinimet e Bizneseve* – Qellimi i paragrafit 52 (përfashtim portofoli)

• SNK 40- *Investimet* – Qartësim i Marrëdhënieve mes SNRF 3 dhe SNK 40, kur klasifikimin i pronës si investim apo prone e zotëruar nga pronari.



LC WAIKIKI RETAIL AL Sh.p.k

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

(Vlerat ne Lek)

2.2 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet në lidhje me standardet ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe që nuk janë adoptuar më përpara nga shoqëria

Ne datën e autorizimit të pasqyrave financiare, disa standarde të reja, ndryshime dhe interpretime të standardeve ekzistuese ishin publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) por që nuk janë bërë akoma efektive dhe nuk kanë qenë të adoptuara më parë nga Shoqëria.

Drejtimi i Shoqërisë parashikon që të gjitha deklaratimet do të adoptohen në politikën kontabël të shoqërisë në momentin që këto deklaratime do të bëhen efektive. Informacionet në lidhje me standardet e reja, ndryshimet dhe interpretimet që priten të jenë të rëndësishme për pasqyrat financiare të Shoqërisë parashtrihen me poshtë. Disa standarde dhe interpretime të tjera që janë publikuar nuk priten që të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të shoqërisë:

-SNRF 14 Llogaritja për aktive/detyrime të shtyra për arsye rregullatore;

-SNRF 15 Të ardhura nga kontratat me klientët;

-SNRF 16 Qiratë

-Ndryshimet në SNRF 11: Kontabiliteti për blerje të interesave në një operacion të përbashkët

-Ndryshimet në SNRF 10, 12 dhe SNK 28: Njësitë Ekonomike Investuese- aplikon përjashtime të konsolidimit

-Ndryshime në SNK 16 dhe SNK 38: Sqarim mbi metodat e pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit

-Ndryshimet në SNK 1: Nisma e dhënies së informacionit shpjegues

-Ndryshime në SNK 16 dhe SNK 41: Plants (Bimët/ndertësa) bartëse

-Ndryshime në SNK 19: Skemat e përfitimeve të përcaktuara: Kontributi i punonjësve

-Ndryshimet në SNK 27: Metoda e kapitalit neto në një pasqyrë financiare të veçantë

-Ndryshime në SNK 7: Nisma e dhënies së informacionit shpjegues

-Ndryshimet në SNK 12: Njohja e aktiveve për tatime të shtyra për humbjet e parcalizuara

-Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 Shitja ose kontributet e aktiveve midis një investitori ose sipërmarrjeje të përbashkët.

3 Politika kontabel të rëndësishme

3.1 Baza e përgatitjes dhe përputhshmërisë

(a) Baza e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e publikuara nga Komisioni i Interpretimeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KINRF") të BSNK. Zbatimi i SNRF-ve është sipas Ligjit Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 742, datë 7.11.2007. Këto janë pasqyrat financiare të Shoqërisë të para të përgatitura në përputhje me SNRF dhe është aplikuar SNRF 1 "Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar". Një shpjegim se si SNRF-te kanë ndikuar në pasqyrën e pozicionit financiar, rezultatet nga operacionet dhe flukset monetare të Shoqërisë jepet në shënimin 24.

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuar nga SNRF për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e vlerësimit janë përshkruar në mënyrë më të qartë në politikën kontabël të paraqitura si më poshtë.



LC WAIKIKI RETAIL Al Sh.p.k

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

(Vlerat ne Lek)

3 Politika kontabel te rëndësishme (vazhdim)

3.1 Baza e përgatitjes dhe përputhshmërisë

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në koston historike.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat Financiare janë pasqyruar në "Lek" e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

(d) Përdorimi i gjykimit dhe i vlerësimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi i shoqërisë të bëjë gjykime. vlerësime dhe supozime që mund të ndikojnë në aplikimin e politikave si dhe vlerave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet kryesore janë rishikuar në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabel njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në çdo periudhë të ardhshme në të cilën mund të ketë ndikim.

3.2 Parimi i vijimësisë

Te dhenat e kontabilitetit jane mbajtur duke qene ne perputhje me parimet e pergjithshme te kontabilitetit, ne menyre te vecante me bazen e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhes, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit ne vijimesi.

Pasqyrat financiare jane përgatitur sipas parimit te vijimesise, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjate ecurise normale te biznesit.

3.3 Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Të gjitha humbjet dhe fitimet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e këtyre transaksioneve dhe nga rivlerësimi i zërave monetare ne monedhë të huaj me kursin e këmbimit të fundit të vitit njihen në fitim ose humbje.

Zërat jo-monetare nuk ri këmbehen në fund të periudhës dhe maten me kosto historike (këmbehen duke përdorur kursin e këmbimit në datë kur është kryer transaksioni), përveç rasteve kur zërat jo-monetare maten me vlerë të drejtë të cilat këmbehen duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të aplikuara (Lek kundrejt monedhave të tjera të huaja) për monedhat kryesore me 31 Dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2015	31 Dhjetor 2014
USD	125,79	115,23
EUR	137,28	140,14



LC WAIKIKI RETAIL Al Sh.p.k

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

(Vlerat ne Lek)

3 Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.4 Aktivët afatgjatë materiale

(i) *Njohja dhe matja*

Elementet e aktiveve afatgjatë materiale mbahen me kosto historike pakësuar zhvlerësimin e akumuluar (si më poshtë) dhe çdo humbje tjetër nga rënia në vlerë (referohuni politikën kontabël 3.6).

Kostot historike përfshijnë të gjitha shpenzimet që i atribuohen marrjes dhe përdorimit të aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë përfshin kostot e materialeve dhe punën direkte, dhe çdo kosto tjetër të atribueshme për sjelljen e aktivit në kushte pune për përdorimin e destinuar të tij, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktivit si dhe rregullimin e vendit në të cilin janë vendosur dhe kapitalizimin e koston së huamarrjeve.

Në rastet kur elementet e një aktivi material afatgjatë kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato mbahen si aktive afatgjatë materiale më vete (komponentët kryesore).

(ii) *Kostot e mëposhme*

Kosto e zëvendësimit të pjesëve të aktiveve afatgjatë materiale i shtohet vlerës së mbartur të aktivit vetëm në qoftë se parashikohet që kjo pjesë të sjellë përfitime ekonomike në të ardhmen për shoqërinë dhe kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve materiale afatgjatë njihen në shpenzimet e periudhës kur ndodhin.

(iii) *Zhvlerësimi (Amortizimi)*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare apo zbritese të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirës dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Instalime teknike	Mbi vlerën kontabel neto	5%
Mobilje dhe pajisje zyre	Mbi vlerën kontabel neto	20%
Pajisje informatike	Mbi vlerën kontabel neto	25%
Mjete transporti	Mbi vlerën kontabel neto	20%

Vlera e mbetur dhe jetëgjatësia e aktiveve afatgjatë materiale shqyrtohet, dhe rregullohet nëse është e përshtatshme, në çdo datë të Pasqyrës së pozicionit financiar. Vlera kontabël e një aktivi shpenzohet menjëherë deri në shumën e rikuperueshme, nëse vlera kontabël e aktivit është më e madhe se shumën e rikuperueshme.

Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohet duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël. Këto janë të përfshira në fitimin ose humbjen e periudhës financiare.



LC WAIKIKI RETAIL AL Sh.p.k

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

(Vlerat ne Lek)

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.5 Aktivet afatgjata jo-materiale

Aktivete afatgjata jo-materiale të blera nga shoqëria paraqiten me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga rënia në vlerë (nëse ka) . bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar pas datës së cilës ato janë të gatshme për përdorim. Jetëgjatësia dhe metoda e amortizimit të aktiveve afatgjata jo-materiale shqyrtohet, në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe efektet e ndryshimit merren parasysh në periudhat e ardhshme.

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Programe kompjuterike	Mbi vleren kontabel neto	25%
Licenca	Metoda lineare	15%

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të shoqërisë , përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra, shqyrtohen në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ndonjë tregues i tillë ekziston , atëherë vlera e rikuperueshme e aktivitetit rivlerësohet. Kur vlera kontabël e tejkalon vlerën e rikuperueshme, njihet një humbje nga zhvlerësimi. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje.

3.6 Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e vogël se vlera e tij e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktiviteti apo grupet e tjera të aktiveve. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset monetare të ardhshme skontojnë për të sjellë në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivitetit.

Në lidhje me aktivitetet e tjera, një humbje nga zhvlerësimi rimerret në qoftë se ka ndonjë tregues që ky zhvlerësim nuk ekziston më dhe ka pasur ndryshime në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerat e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret deri në masën që vlera kontabël e aktivitetit nuk e kalon vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar, neto nga amortizimi dhe zhvlerësimi, në qoftë se asnjë humbje nga zhvlerësimi nuk është njohur.

3.7 Inventarët

Inventarët maten me vlerën më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e çmuara të përfundimit dhe kostot e çmuara që duhen për realizimin e shitjes.

Kostot e inventarit përcaktohen duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar , e cila përfshin të gjitha kostot e blerjes, transportit, tarifave doganore dhe sigurimit gjatë transportit, kostot e konvertimit dhe çdo kosto tjetër që lidhet me inventarin për të sjellë atë në vendin dhe kushtet e punës.



LC WAIKIKI RETAIL Al Sh.p.k

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

(Vlerat ne Lek)

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.8 Instrumentet financiare

Shoqëria zotëron vetëm instrumente jo derivativë financiare të përbëre nga klientë dhe llogari të tjera të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente me to. hua, furnitorë dhe të tjera llogari të pagueshme. Instrumentet financiare jo-derivativë njihen fillimisht me vlerë të drejtë. Për instrumentet e njohur jo me vlerë të drejtë kostot direkt të atribuueshme shkojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç siç është përshkruar si më poshtë. Pas njohjes fillestare njohja e instrumenteve financiare jo-derivativë matet si më poshtë.

Një instrument financiar njihet në qoftë se shoqëria bëhet pjesë e një provigjoni kontraktual mbi instrumentin. Instrumentet financiare pushojnë së njohuri në qoftë se të drejtat kontraktuale të shoqërisë për flukse monetare përfundojnë ose shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë tjetër pa zotëruar më kontroll mbi të ose në mënyrë domethënëse mbi rreziqet dhe përfitimet e aktivit.

Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit të tyre, që do të thotë në datën kur shoqëria angazhohet për të blerë apo shitur aktivin. Detyrimet financiare pushojnë së njohuri në qoftë se detyrimet kontraktuale të shoqërisë përfundojnë apo anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat rrjedhëse në banka apo investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet 3 ose më pak muaj, për të cilat rreziku i një ndryshimi në vlerën e drejtë është i pakonsiderueshëm, investime të cilat shoqëria i përdor për menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e tyre të amortizuar.

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë dhe vlerësuar më pas me kosto të amortizuar pakësuar me humbjet nga zhvlerësimi.

Një provizion për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme njihet kur ka një evidence objektive që shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledh të gjitha shumat në përputhje me termat e llogarive të arkëtueshme.

Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia e falimentimit, riorganizimi financiar si dhe pagesat me vonesë janë tregues për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

Shuma e provizionit është diferenca midis vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet me maturitet të shkurtër nuk skontohen. Vlera kontabël e aktivit zvogëlohet duke përdorur një llogari zhvlerësimi dhe vlera e humbjes njihet në fitim ose humbje.

Kur një llogari e arkëtueshme është e pambledhshme, ajo mbyllet duke përdorur llogarinë e zhvlerësimit. Vlerat që mund të rikuperohen në të ardhmen për shumat e njohura si borxh i keq njihen në fitim ose humbje.



M/

LC WAIKIKI RETAIL Al Sh.p.k

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

(Vlerat ne Lek)

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.8 Instrumentet financiare (vazhdim)

Huatë

Pas njohjes fillestare huatë interes mbartëse janë paraqitur me kosto të amortizuar dhe çdo diferencë ndërmjet koston dhe vlerës së huasë është njohur në pasqyrën e të ardhurave përgjatë periudhës me bazë interesi efektiv.

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera të pagueshme

Llogaritë e pagueshme ndaj furnitorëve të tjerë janë paraqitur me vlerë të drejtë, rrjedhimisht me koston e tyre të amortizuar.

Njohja e zhvlerësimit për aktivet financiare

Një aktiv financiar merret në konsideratë për efekt zhvlerësimi në qoftë se ekzistojnë tregues objektive që një ose më tepër ngjarje mund të kenë ndikim negativ në flukset e pritshme të ardhshme që do të gjenerojë ky aktiv.

Një humbje nga zhvlerësimi në raport me një aktiv financiar të matur dhe të amortizuar me kosto llogaritet si diferencë midis vlerës së mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhme të skontuara me normën e interesit efektiv.

Aktivet financiare me vlerë të konsiderueshme testohen për zhvlerësim individual. Pjesa tjetër e aktiveve financiare grupohen në grupe me karakteristika rreziku të njëjta. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në fitim ose humbje. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret në qoftë se rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi fillestar. Rimarrja bëhet në fitim ose humbje.

3.8 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar konsiston në mjetet monetare të kontribuara nga themeluesit e shoqërisë. Kapitali aksionar paraqitet me vlerën në Lek të konvertuar me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali aksionar i shoqërisë njihet me vlerë nominale.

3.9 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga shitja e mallrave dhe kryerja e shërbimeve. Të ardhurat nga produktet dhe shërbimet kryesore paraqiten në shënimin 14.

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të parave të marra ose të arkëtueshmeve nga shoqëria për mallrat e dhëna ose shërbimet e kryera, duke përfshirë taksat e shitjes, rabatet, dhe uljet tregtare.

Shoqëria aplikon kriteret e njohjes së të ardhurave të përcaktuara si më poshtë tek çdo komponent i veçantë i transaksionit të shitjes në mënyrë që të reflektoje thelbin e transaksionit. Të ardhurat e marra nga këto transaksione janë alokuar tek komponentët e veçantë të identifikuar duke patur parasysh vlerën relative të drejtë të çdo komponenti. Të ardhurat njihen kur vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri, mbledhja është e mundshme, kostoja e ndodhur ose që do të ndodhë mund të matet me besueshmëri, dhe kur kriteret për çdo aktivitet të ndryshëm të shoqërisë janë plotësuar.

LC WAIKIKI RETAIL AI Sh.p.k

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

(Vlerat ne Lek)

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.9 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

Këto kritere njohje specifike për çdo aktivitet janë bazuar në mallra dhe zgjidhje të dhëna klientit dhe në kushtet e kontratës për çdo rast dhe përshkruhen më poshtë:

Shitja e mallrave – me pakicë

Shitja e mallrave njihet kur produktet i shiten konsumatorit. Shitjet me pakicë bëhen zakonisht me para ose me kartë krediti. Të ardhurat e njohura janë vlerat e shitjes bruto, duke përfshirë tarifat e kartës së kreditit të pagueshme për transaksionin.

Ofrimi i shërbimeve

Të ardhurat nga shitja e shërbimeve do të njihen në periudhën në të cilën shërbimet ofrohen, duke iu referuar fazës së realizimit të tyre në qoftë se një gjë e tillë mund të matet në mënyrë me besueshmëri.

Të ardhurat nga interesat

Të ardhurat nga interesat përlogariten në mënyrë të vazhdueshme mbi baza kohore, bazuar në principalin e mbetur dhe normës së interesit efektiv të aplikueshëm cila është norma që skanton dhe barazon saktësisht të flukset monetare të ardhshme përgjatë jetës së pritshme të aktivitetit financiar me vlerën kontabël neto të aktivitetit.

3.9 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurime shoqërore

Gjatë ushtrimit të aktivitetit operativ, shoqëria kryen pagesa periodike për llogari të punonjësve për pjesën që ligjërisht i takon të paguajë shoqërisë dhe punonjësve për të kontribuar për fondet e detyrueshme të pensioneve sipas rregullimeve të legjislacionit vendas. Kostot e shoqërisë janë përfshirë në llogaritjen e rezultatit të periudhës.

3.10 Tatim fitimi i vitit dhe tatim fitimi i shtyre

Shpenzimet për tatim fitimin përfshijnë tatim fitimin aktual dhe tatim fitimin e shtyre. Shpenzimet për tatim fitimin njihen në fitim ose humbje deri përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera përmbledhëse.

Tatimi mbi fitimin aktual është tatimi i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme duke përdorur normat e taksimit në datën e raportimit dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm të lidhur me vitin e kaluar. Tatimi mbi fitimin i aplikueshëm është 15% e fitimit të tatueshëm.

Tatim fitimi i shtyre njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyre matet me normat tatimore që pritet të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato ndryshojnë, duke u bazuar në ligjet që kanë qenë ose janë në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyre njihet në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme do të jenë në dispozicion për të mbuluar diferencat e përkohshme. Aktivitet tatimor të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në qoftë se përfitimet tatimore nuk do të jenë më të mundshme për tu realizuar.



LC WAIKIKI RETAIL Al Sh.p.k

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

(Vlerat ne Lek)

3. Politika kontabël të rëndësishme (vazhdim)

3.11 Provigjonet

Provigjonet njihen kur shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një rrjedhje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të shlyer detyrimin dhe kur një vlerësim i besueshëm i vlerës së detyrimit mund të bëhet. Nëse efekti është material, provigjonet llogariten duke zbritur vlerën e pritshme të mjeteve monetare të ardhshme para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të pasasë, dhe kur është e nevojshme rrezikun specifik të detyrimit.

Provigjonet rishikohen ne çdo datë raportimi dhe nëse nuk është më e mundshme që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkoher për të shlyer detyrimin, provigjoni anulohet. Provigjonet përdoren vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provigjonet nuk njihen për humbje të ardhme operative. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në kontabilitet.

Provigjonet per kthimin e mallrave te shitura do te njihen si "detyrime per kthimin e shitjeve" per vlerën e te ardhurave nga shitja e tyre me kundraparti pakësimin e te ardhurave nga shitja; dhe "te drejta per kthimet e shitjeve" për të pasqyruar te drejtën për të rimarrë produktet nga konsumatorët ne zgjidhjen e përgjegjësisë per rimbursim, me kundraparti pakësimin e kostos se mallrave te shitura.

3.12 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese nëse mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivët e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet shpjeguese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme. Shuma e një humbje të kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provigjonin, një detyrim njihet ne datën e Pasqyrës e pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet ne mënyrë të besueshme.

3.13 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarë dhe drejtorët e shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme, vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

3.14 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e Pasqyrës se pozicionit financiar (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

4 Menaxhimi i rrezikut financiar

4.1 Faktorët e rrezikut financiar

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare, që përfshijnë rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja dhe normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut të shoqërisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizojë efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit të shoqërisë.

LC WAIKIKI RETAIL AL Sh.p.k

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2015

(Vlerat ne Lek)

Menaxhimi i rrezikut kryhet nga drejtimi bazuar në politika të aprovuara dhe procedura që mbulojnë gjithë menaxhimin e rrezikut, si dhe çështje specifike, si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normës së interesit, rreziku i kreditit, dhe investimi i likuiditetit të tepërt.

4.2 Rreziku i tregut

Rreziku i kursit të këmbimit

